



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P.nr.277/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Diana Sina dhe sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit, B. R. nga Lagja B. Komuna Gjakovë, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti-Përgjithshëm në Gjakovë, PP.nr.1641/2017 të dt.06.04.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, **me dt.05.07.2018**, murr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë, PP.nr,1641/2017 të dt.06.042018, dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

B. R.,i biri B. dhe i ëmës Sh. , e gjinisë K. , data e lindjes... , në fsh. D. K.Gjakovë, e tani me banim në Lagjen B. Komuna Gjakovë rr.”M.”nr.....,punëtor, i martuar , i gjendjes te mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës. me Lnj.....,

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

Me datë 31.10.2017 rreth orës 15:30min, në Gjakovë rr “P.N. L.” pn, nga pakujdesia nuk ndërmer masa të duhura për mbrojtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe dëmton tubacionin e ujit të pijshëm, e të dëmtuarës Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “R.”në Gjakovë,i shkakton dëm material si dhe të dëmtuarës M. M. Zh. nga Gjakova rr,P. N.L.” pa nr,i shkakton dëm material, ashtu që deri sa ishte duke punuar me aparaturë e ishte duke e shpuar tokën për të vendosur një kablo eklektike në pronën e A. G. nga Gj., gjatë punës aparatura i has në gyp të ujit ku e dëmton, e uji nga konfiguracioni i tokës, vërshon dhe depërton në dhomën e ndejës së dëmtuarës M. Zh.

-Me çka ka kryer veprën penale asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 366 par.2të KPRK-së.

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73,dhe nenit 366/2 te KPRK-së ,dhe nenit 495 të KPPK-së akuzuarit i:

S H Q I P T O N

Dënimin me gjobë në shumë prej **250,00.-€ (dyqind e pesdhjetë)euro**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi - Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 46 par.4 të KPPK-së ,i zëvendësohet me dënim burgim i në kohëzgjatje prej **12 (dymbëdhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20.-€ (njëzet euro)**.

E dëmtuara Kompania Rajonale e Ujësjesit “R.”në Gjakovë dhe M.M. Zh., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.nr.1641//2017 të dt.06.04.2018, ndaj të akuzuarit, B. R. nga Gjakova lagjja B. ,për shkak të veprës penale asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 366 par.2 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjakovë, komfor nenit 493 të KPPK-së, kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhrë ndëshkimor dhe të njëjtit t’i shqiptohet dënim me gjobë.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet me çka ka kryer veprën penale , të veprës penale asgjësim, dëmtim ose heqje e instalimeve publike nga neni 366 prg,2 të KPRK-së, dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrë ndëshkimor dhe ti shqiptoi të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t’i referohet dispozitës së nenit 366 par. 2 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë ne 1 (një) vitë.

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrë ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr..... i dt.31.10.2017,deklarata e të akuzuarit B.R. e dhënë në stacionin policor në Gjakovë, me dt. dt.31.10.2017,Deklarata e të dëmtuarës M.Zh., e dhënë në stacionin policor në Gjakovë, me dt.31.10.2017,deklarata e dëshmitarit R. R. e dhënë në stacionin policor në Gjakovë me dt.31.10.2017,raporti i oficerit lidhur me rastin me fotot e vendit të ngjarjes, raporti i komisionit për vlerësimin e dëmit të shkaktuar ne rrjetin e ujësjesit i K.R.U. R. në Gjakovë, i dt.02.10.2017, si dhe shkresat e tjera të cilat janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës, të cilat janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par.2 nën.par. 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.277/18 te dt.05.07.2018

Sekretarjajuridike:

Lamije Kuqi

Gjyqtarja
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarës të kësaj Gjykate.